



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:002068

Datë: 31.01.2022

Numri i dokumentit: 02663266

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.1/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekalii, me zyrtaren ligjore Kaltrina Sfarqa, në çështjen penale kundër të pandehurve M.G, nga V, rr.”L.L”, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, (tutje KPRK), dhe P.G, nga V, rr.”L.L”, për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.39/20 të datës 30.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 28.01.2022, në praninë e Prokurores së Shtetit Jakodinka Nikoliq, të pandehurve M.G, P.G, dhe të dëmtuarit I.Rr, me datë 28.01.2022 shpalli, ndërsa me datë 31.01.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri : M.G, nga i ati B, e ëma N, mbiemri i vajzërisë P, i lindur me datën....., me vendbanim në rrugën “L.L”, në V, i martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. I pandehuri: P.G, nga i ati M, e ëma S, mbiemri i vajzërisë Sh, i lindur me datën....., me vendbanim në rrugën “L.L”, në V, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I pandehuri i parë:

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 23.12.2019 rreth orës 22:30 në Vushtrri, saktësisht në urgjencën e ambulancës që gjendet në rr.”D.K”, i pandehuri M pas kontrollit mjekësor që kishte tek i dëmtuari mjek kujdestar I.Rr, i pandehuri pas ndihmës mjekësore që mori nga i dëmtuari I kërkon trajtim të mëtutjeshëm, ku i dëmtuari e udhëzon që për probleme tjera shëndetësore duhet ti drejtohet mjekësisë familjare, me c’rast i dëmtuari e kanosë seriozisht me fjalët se “E sheh se kush jam

unë dhe si te dalësh prej punës ki me pa se kush jam unë”, me c;rast i dëmtuari nga këto fjalë ndihet i frikësuar se do ti ndodhë diçka e keqe nga i pandehuri

- **Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.**

I pandehuri i dytë:

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Po me datë, ditën dhe vendin si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze i pandehuri P pasi mbërriti në emergjencë për ta marr babin e vet-të pandehurin M, i pandehuri P me dashje e sulmon personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare të dëmtuarin-mjekun I.Rr në atë mënyrë që niset-vërsulet në drejtim të të dëmtuarit me një thikë në dorë, aty ndërhyjnë kolegu mjeku tjetër K.H i cili e ndalon të pandehurin që mos ta godet të dëmtuarin dhe gjatë këtij veprimi gërvishtë gishtin tregues të dorës së djathtë nga thika e të pandehurit.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar, nga neni 402 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 46, 47, 48,49, 56, 69, 70 të KPRK-së, dhe nenit 115, 365, 450 dhe 461 të KPPK-së, të pandehurit i:

GJYKON

Të pandehurin: M.G, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikues prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë tjetër penale.

Të pandehurin: P.G, e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 2 (dy) viteve, nuk kryen veprë tjetër penale.

Konform nenit 115 par. 1 dhe 2 nën par. 2.3 të KPPK-së,

URDHËROHET

Konfiskimi në mënyrë të përhershme i armës-briskut me ngjyrë të zezë, e cila ka qenë e sekueskuetuar në mënyrë të përkohshme nga i pandehuri P.G.

DETYROHEN të pandehurit, që në emër të paushallit gjyqësor në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 30 euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimet, shumën prej 30 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari I.Rr, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.39/20 të datës 30.12.2020, kundër të pandehurve M.G, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 i KPRK-së dhe P.G, për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.1 i KPRK-së .

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 28.01.2022, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurorja e Shtetit Jakodinka Nikoliq, të pandehurit M.G dhe P.G, i dëmtuari I.Rr dhe përkthyesja e gjykatës Hadije Bllata.

Pas leximit dhe përmirësimit të aktakuzës, nga ana e Prokurores së Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohen, si dhe sqarimit të benifitieve dhe pasojave të pranimin të fajësisë, të njëjtëve u është ofruar mundësia që të deklarohen lidhur me fajësinë. Të pandehurit M.G dhe P.G janë deklaruar fajtor për veprën penale që u vihet në barrë, janë penduar për veprën, i kanë premtuar gjykatës së në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra penale të kësaj natyre apo natyrave të tjera, është hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin, si dhe i propozuan gjykatës se me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh gjendjen e tyre ekonomike.

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në drejtim të veprave penale të lartë shënuar, për arsye se pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, pa as njëlloj detyrimi dhe se ky pranim i fajësisë mbështet në provat e propozuara në aktakuzë, i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësie nga të pandehurit, si dhe pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të të pandehurit të parë si dhe gjendjen ekonomike të të dy të pandehurve kërkoj nga gjykata që ndaj të njëjtëve të shqiptoj ndonjë sanksion sa më të lehtë penal, përkundër që unë jam i dëmtuar me këto vepra penale, si dhe pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e dy të pandehurve, si dhe kërkoj që në të ardhmen të mos përsëriten sjellje të tilla në institucione shëndetësore për arsye se ne jemi të pambrojtur në aspektin fizik dhe në aspekte tjera.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: raportet e Policisë së Kosovës me numër 2019-BD-894 nga data 23.12.2019, deklarata e të pandehurit M.G, e datës 23.12.2019, deklarata e të pandehurit P.G, e datës 23.12.2019, deklarata e të dëmtuarit, e datës 23.12.2019, deklarata e dëshmitarit, e datës 23.12.2019 vërtetimi i sekuestrimit të armës-briskut, si dhe vështrimi i fotodokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të pandehurin e parë ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe faktin se i pandehuri e ka kryer këtë veprë me dashje, faktin se i dëmtuari ishte në krye të detyrës duke i ofruar të pandehurit trajtimin e nevojshëm mjekësor, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, faktin se nga koha e kryerjes së kësaj veprë penale, gjendjen e tij shëndetësore, gjendjen e tij ekonomike, pajtimin me palën e dëmtuar dhe propozimin e palës së dëmtuar që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim sa më i butë, ndërsa për të pandehurin e dytë, si rrethana rënduese gjykata ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, pasojën që do mund të shkaktohej nga kryerja e kësaj veprë penale, faktin se vepra penale është kryer në një institucion shëndetësor, si dhe faktin se i pandehuri e ka kryer këtë veprë me dashje, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, faktin se nga koha e kryerjes së kësaj veprë penale, i pandehuri nuk ka kryer vepra të kësaj natyre apo të ndonjë natyre tjetër, gjendjen e tij ekonomike, se janë pajtuar më të dëmtuarin dhe propozimin e palës së dëmtuar që ndaj të pandehurit të shqiptohet një dënim sa më i butë.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këto dënime të shqiptuara ndaj të pandehurve do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që të pandehurit në të ardhmen të kenë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, konfiskim e përherëshëm të armës, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Pala e dëmtuar I.Rr, në seancën e datës 28.01.2022 ka deklaruar se heq dorë nga kërkesa pasurore juridike, andaj gjykata për këtë pikë të aktgjykimit vendosi konform nenit 461 të KPPK-së.

Vendimin për konfiskim e përherëshëm të armës-briskë ngjyrë e zezë, gjykata e mori konform nenit 115 par. 1 dhe 2 nën par. 2.3 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.1/2021, datë 31.01.2022

Zyrtarja Ligjore
Kaltrina Sfarqa

Gj y q t a r i
Naim Rekalii

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.